

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “ Riparim Trotuari Sheshi Tahir Sinani B. Curri ”**

**Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Kodi CPV : hekur-14711000-8, beton-44114000-2, pllaka betoni-44114250-9**

**Fondi limit: 3, 008,213 ( tremilionetetmijedyqindetrembedhete) leke pa tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”( i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tropoje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

**2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:**

Sipas kriterëve të përgjithshme për kualifikim.

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022,2023), ku vlera e xhiros për 3 (tre) vitet e fundit duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të kontratës që prokurohet.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, te ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" etj.

**2.2.2** Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2021,2022,2023), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2023 dhe keestet e maturuara te vitit 2024**, pranë njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

**Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikoje vertetesine e informacionit te paraqitur ne zbatim te Ligjit nr.162/2020 date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik" dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 " Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006,"Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike",etj.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

- i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit<sup>1</sup> që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikaten e marrjes në dorezim të perkohshëm/përfundimtar.

**Shënim :** *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Kontrate Sipërmarrje;
  - Situacionin përfundimtar;
  - Faturat tatimore;
  - Akt kolaudimi objekti.
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Në rast se një OE/BOE rezulton si ofertues i suksesshëm për më shumë se një lot, ky i fundit duhet të vërtetojë se i plotëson kërkesat për kualifikim sipas pikës 2.3.1, të Kapacitetit Teknik, në raport me shumatorën e kërkesave respektive të loteve për të cilët rezulton i suksesshëm.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 42, , në rastin e procedurave të hapura, në nenin 47, dhe 39 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme në një objekt të vetëm të jenë jo më të madhe se 30% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në baze të nenit 55 pika 4 germa a (i) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar, ose për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet në baze të nenit 55 pika 4 germa a (ii) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021.

**Per te provuar pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale ,kapacitetet teknike dhe profesionale ,autoriteti kontraktor kerkon!:**

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **15(pesembedhjte) punonjës** me kohe te plote dhe te figurojne ne listepagesat e operatorit per tre muajt e fundit te vitit 2024.

**Për vërtetimin e këtij kushti të paraqiten:**

- a)Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
- b>Listëpagesa e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formëselektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

**2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet te kete te punesuar staf si drejtues teknik ne licence per kryerjen e te gjitha punimve ne kete objekt ,te vertetuar me kontrate pune te vlefshme ,diploma apo licence profesionale nqs eshte rasti , si dhe te figurojne dhe ne listepagesat e shoqerise per te gjithe periudhen e kerkuar me lart korrik, gusht, shtator 2024 stafi inxhinierik si me poshte :**

- 1 (nje) inxhinier ndertimi ( drejtues teknik)**
- 1(nje) teknik ndertimi**

**Shoqeria pjesemarrrese duhet te kete te punesuar staf te vertetuar me kontrate pune te vlefshme, diplome si dhe te figurojne dhe ne listepagesat e shoqerise.**

2.3.4 Duke vleresuar rendesine llojshmerine dhe volumi I zerave te punimeve te objektit qe prokurohet cdo shoqeri pjesemarrrese duhet te deshmoje qe ka ne stafin e saj me kontrate pune te vlefshme te domosdoshme per kryerjen e punimeve:

**Stafi teknik:**

- 1 (nje) betonues\ specialist ndertimi**
- **1 (nje) pllakashtrues**
- **2 (dy) manovrator**
- **1 (nje) shofer me leje drejtimi te tipit C**
- **9 (nente) specialist dhe te thjeshte**

Per punonjesit manovratore duhet te paraqiten deshmita e drejtimit nga DPSHTRR (te vlefshme) lëshuar nga institucionet perkatese dhe duhet te paraqitet kontrata e punes e vlefshme.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese së inxhinierët e deklaruar në kërkesën 2.3.4 për kualifikim janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate dhe nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar stafin teknik të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre” bazuar ne perlllogaritjen e oreve te punes , kategorite e punimeve te percaktuara ne preventive, specifikimet teknike te objektit, detajeve te projektit dhe tipologjia e zerave te punimeve , te cilat lidhen ngushtesisht me listen e stafit teknik te kerkuar nga AK , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

**Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë punetorine dhe stafin teknike që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Në çdo rast, përpara se të publikoje njoftimin e fituesit dhe përpara nisjes së afateve të ankimit , autoriteti kontraktor detyrimisht do t’i kërkojë ofertuesit fitues te renditur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit per pikat a, b, d, dh, e, h, I, j te pikes 2 te nenit 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 si edhe dokumentat e tjera shoqeruese te ofertes te dorezuara ne rruge elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

**Argumentimi :** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa specifike për Stafin teknik është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë (kapaciteti teknik në DST) si dhe në përputhje me Stafin inxhinierik të kërkuar (kapaciteti teknik në DST). Stafin teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Për sa më lart, gjykohet e arsyeshme që Ofertuesit duhet të kenë staf teknik sipas pikës 3.5, i cili do të garantojë zbatimin e punimeve sipas Specifikimeve teknike dhe do jetë përgjegjës për realizimin e zërave të Preventivit.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, mjedisit dhe menaxhimit te energjise. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- a) Certifikate ISO 9001:2015 Sistemet e menaxhimit te cilesise/ **ekuivalente dhe e vlefshme**
- b) Certifikate ISO 14001:2015 Sistemet e menaxhimit te ambientit / **ekuivalente dhe e vlefshme**

c) Certifikate ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurise ne Pune)/ **ekuivalente dhe e vlefshme**

**Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe gjatë periudhës së parashikuar për zbatimin e kontratës.**

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, i ndryshuar parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

**ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrorjnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

**ISO 45001-2018** është standard ndërkombëtare, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet te kete në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion mjetet e pajisjet teknike te nevojshme per ekzekutimin e kontrates, si me poshte (sipas formularit permbledhes te vetedeklarimit):

<b>Mjetet</b>	<b>Sasia</b>		<b>Gjendja</b>
Kamion min. 3.5 ton	copë	1	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	copë	1	Pronësi ose me qera
Matrapik	cope	1	Pronësi ose me qera

Vibrator	cope	1	Pronësi ose me qera
Betoniere 500 l	cope	1	Pronësi ose me qera
Autovinc deri ne 5 ton	cope	1	Pronësi ose me qera
Rrul me vibrim	cope	1	Pronësi ose me qera
Autobot uji	cope	1	Pronësi ose me qera

- Për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikaten e pronesisë, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë (vetem mjetet e transportit) dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe per mjetet e siguruar me qera, dokumentet e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten noteriale perkatese te qerases, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Per mjetet e transportit me qera te paraqitet gjithashtu Çertifikatë për transport mallrash për te trete dhe me qira. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fatura tatimore perkatese fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperme, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirases noteriale e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.
- Operatori/Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara do te angazhohen ne kete objekt prokurimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

**Per permbushjen e ketij kriteri operatoret ekonomike duhet te vetedeklarojne mjetet dhe pajisjet qe disponojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit .**

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar mjetet / makinerite të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perllogaritja e oreve te Punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , bazuar ne tipologjine e zerave te preventivit , analizave perkatese te zerave te preventivit etj, nga specialistet perkates te inxhinierë, nga grupi i punes per perllogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve te vecanta teknike te kualifikimit .

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” si edhe nga praktika te meparshme te ngjashme. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky

dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

***Sipas specifikimeve teknike dhe relacionit bashkangjitur DST.***

## **NJESIA E PROKURIMIT**